

VENDIM
Nr.792, datë 26.11.2004

**PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË SË DIVJAKËS TË PRONAVE ME
NUMRAT RENDORË 869, 870, 871, 872 DHE 873, TË CILAT JANË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË MBROJTJES, DHE PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN
E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT
I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 7 e 8 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të nenit 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pronat me numrat rendorë 869 “Batalioni i këmbësorisë”, 870 “Bateri AKA”, 871 “Ish-batalion mitralier”, 872 “Ish-depo municioni” dhe 873 “Ish-poligon qitjeje me aviacion dhe artileri” në Divjakë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, t’i kalojnë në pronësi bashkisë së Divjakës, për t’i përdorur për menaxhimin e Parkut Kombëtar dhe të zonës së mbrojtur të ekosistemit të Divjakës.

2. Ministrisë së Mbrojtjes, nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, e cila i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, t’i hiqen pronat e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi.

3. Bashkisë së Divjakës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në këtë vendim, t’i tjetërsojë apo t’ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Pushtetit Vendor dhe i Decentralizimit, Kryeregjistruesi i Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe kryetari i bashkisë së Divjakës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano